



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Pamirëgjatë/Prodato Received/Delivety	13-06	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot.No	Shkronje Fjalor Appendix	Sasia Kohësina Quantity	
SKIMBHX	3447/2022		1/6	

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.427/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani- anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.427/2022 të datës 27.04.2022 nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/ Thesari i Kosovës në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.427/2022 e datës 27.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër 04/2022 i datës 13.04.2022 dhe Vendimi me numër 11/2022 i datës 21.04.2022 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Thesarit të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 01.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Thesari i Kosovës/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve sipas njoftimit të datës 14.03.2022 për aplikim nga data 29.03.2022 për lëvizje brenda kategorisë në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë i Thesarit", me numër reference RN00008525.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin numër 04/2022 të datës 13.04.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN0004011

të ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesja nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe rrjedhimisht e njëjta nuk është përfshirë në listën e shkurtër të kandidatëve. Ankuesja kundër Vendimit me Nr.04/2022 të datës 13.04.2022, me datë 15.04.2022 ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës/MFPT.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës/MFPT me datë 21.04.2022 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.11/2022, me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar, të cilin vendim thekson se ende se ka pranuar sipas ankesës së datës 15.04.2022, dhe në këtë kuptim me datë 27.04.2022 ka parashtruar ankesën përmes postes elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me datë 27.04.2022 me numër të protokollit 2452/2022, e plotësuar me datë 29.04.2022 kundër Vendimit me Nr.04/2022 të datës 13.04.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës/Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me pretendime ankimore se i plotëson kriteret e përgjithshme dhe formale për të qenë e përfshirë në listën e ngushte në procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i lartë i Thesarit".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 11.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Thesarit e Kosovës/Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit me datë 17.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2874/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2452/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postes elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, me datën 27.04.2022, e plotësuar me datë 29.04.2022 me numër protokollit 2519/2022; Raport për verifikimin e të dhënave të aplikuesit i datës 04.03.2022 i lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Ekonomik; Vërtetimi i datës 12.04.2022 me numër ref.12/1595 i lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Ekonomik; Formulari për mbrojtjen e punimit të diplomës master i datës 04.03.2022 me nr.protokollit 01/96 i lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinës-Fakulteti Ekonomik(Formulari- F4); Vendimi Nr.04/2022 me numër protokolluar 113 i datës 13.04.2022 i Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Thesarin i Republikës së Kosovës; Ankesa e datës 15.04.2022; Akt emërimi i datës 01.07.2018; Akt emërimi i datës 01.07.2019; Vendim i datës 19.03.2021; Vërtetim i datës 31.03.2022; Vërtetim i datës 30.03.2022; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.11.2020; Formuarin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.01.2022; Certifikatën me nr. 1763/2022 e datës 31.03.2022 lëshuar nga Gjykata Themelore në Priashtinë -dega Podujevë; Vendim i datës 05.04.2022 i lëshuar nga Policia e Kosovës; Certifikatën Nr.149/2021; Diplomën me Nr.6367 të datës 05.04.2016; Përgjigje në ankesë e datës 17.05.2022 me numër protokollit 2874/2022; Vendim

datës 21.04.2022 me numër protokolli 124 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Thesarit e Kosovës; Konkursi i datës 14.03.2022, për aplikim nga data 29.03.2022 deri me datë 06.04.2022; Aplikacioni i ankueses i datës 01.04.2022; Akt emërimi i datës 07.07.2018; Diploma Nr.6367 e ankueses e datës 05.04.2016; Formulari i datës 04.03.2022 i lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina" në Prishtinë; Vërtetimi i datës 31.03.2022; Vërtetimi i datës 30.03.2022; Vendimi i datës 19.03.2021; Akt emërimi i datës 07.07.2018; Certifikatë e datës 31.03.2022 e lëshuar nga evidenca penale Gjykata Themelore në Prishtinë dega Podujevë; Vërtetim i datës 05.04.2022 lëshuar nga Policia e Kosovës; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.11.2020; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.02.2022 ;Lista e aplikacioneve nga sistemi SIMBNJ-së; Aplikacioni i K.G; Akt emërimi i datës 04.03.2019; Diplomë nr.1635 i datës 11.12.2018 e motorizuar me numër LRP.nr.7655/2021; Diplomë me nr. 5590 i datës 17.09.2015 e motorizuar me numër LRP.7654/2021; Certifikatë e datës 18.07.2019; Certifikatë e datës 29.07.2016; Kontratë e shërbimeve e datës 04.06.2018; Kontratë e shërbimeve e datës 26.06.2018;Vërtetim mbi përvojën e punës e datës 23.11.2021; Referencë e datës 25.11.2021 ;Vërtetim e datës 26.11.2021; Vendim e datës 19.08.2019; Letër reference e datës 22.11.2016; Referencë e datës 05.11.2015; Referencë e datës 24.07.2018; Rekomandim e lëshuar nga Dogana e Kosovës 1/2 faqe; Informim i datës 25.11.2021 nga Sh.K.Ç.A.K; Vendim i datë 26.11.2021; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 20.12.2019; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.11.2020; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 07.12.2021; Certifikatë e datës 05.04.2022 e lëshuar nga evidenca penale Gjykata Themelore në Prishtinë dega Podujevë; Vërtetim i datës 12.04.2022 i lëshuar nga Policia e Kosovës; Aplikacioni i kandidatit M.K.; Akt emërimi datës 01.12.2012; Diplomë me nr. 232 i datës 18.12.2012; Diplomë e datës 24.05.2002; Letër rekomanduese e datës 28.07.2010; Letër rekomanduese e datës 07.10.2009; Vërtetim e datës 15.09.2005; Vërtetim e datës 01.11.2019; Vërtetim e datës 14.06.2021; Vërtetim nr.13-113/01-0047660/21 e datës 14.06.2021; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 01.12.2020; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.01.2022; Certifikatë nr.129/2020; Certifikatë e datës 22.01.2010; Certifikatë e datës 08.09.2015; Certifikatë raportim financiar; Certifikatë e datës 28-29.2018; Certifikatë e datës 16.11.2007; Certifikatë e datës 08.12.2010; Certifikatë e datës 28.03.2022 e lëshuar nga evidenca penale Gjykata Themelore në Prishtinë dega Podujevë; Vërtetim i datës 23.03.2022 i lëshuar nga Policia e Kosovës; Aplikacioni i kandidatit L.M.S.; Akt emërimi datës 24.07.2015; Diplomë me nr.271/45-65 i datës 30.07.2019; Diplomë NR.76/45-64 e datës 19.12.2012; Certifikatë e datës 24.12.2017 KAF; Certifikatë e datës 11-12 05.2017; Certifikate e datës 12.11.2015 KAF; Certifikate e datës 10.11.2011; Certifikate e datës 15.05.2011; Certifikate e datës 28.01.2011; Certifikate e datës 07.07.2009; Certifikate e datës 05.08.2011; Referencë e datës 04.03.2015; Referencë letër e datës 28.03.2015; Vërtetim e datës 27.03.2015; Formulari për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 07.02.2019; Vërtetim e datës 05.04.2019; Certifikatë e datës 06.04.2022 e lëshuar nga evidenca penale Gjykata Themelore në Prishtinë dega Mitrovicë; Vërtetim i datës 08.04.2022 i lëshuar nga Policia e Kosovës; Prova shtesë nga Thesari i Kosovës përmes e-mailit të datës 07.06.2022, sipas kërkesës së Këshillit të datës 07.06.2022; Njoftimi nr.128 i datës 21.04.2022; Njoftimi nr.111 për listën e ngushtë e datës 13.04.2022; Njoftim i datës 22.04.2022; Njoftimi nr.131 i datës 29.04.2022 për kandidatin fitues; E-mail i datës 22.05.2022 për kandidatin e suksesshëm dhe kandidatët që i janë nënshtruar intervistës me gojë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses _____ është e pa bazuara, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 14.03.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i lartë i Thesarit" me numër RN00008525 në Thesarin e Kosovës/Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 29.03.2022 deri me datë 06.04.2022, dhe si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë të përcaktuara si ne vijim:

-Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e studimeve Universitare në Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e një apo vazhdim(specializim)i Diplomës Bachelor),

Kualifikime të posaçme formale,

-Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy(2)vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës

Sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja me datë 01.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i lartë i Thesarit" me numër reference RN00008525 në Thesarin e Kosovës, mirëpo Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin Nr.04/2022 të datës 13.04.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN0004011 të ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesja nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe e njëjta nuk është përfshirë në listën e shkurtër të kandidatëve. Rrjedhimisht ankueses me bazë të njëjte i është refuzuar edhe ankesa e parashtruar kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit.

Ankuesja _____ në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bërë e pa drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit për pozitën e punës "Zyrtar i lartë i Thesarit" sepse e njëjta pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe për këtë ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme si Formularin për mbrojtjen e punimit të diplomës master, si dhe Vërtetimin që dëshmon se ka diplomuar me datë 04.03.2022, dokumente këto të nënshkruara, vulosura dhe protokolluara nga Fakulteti Ekonomik - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Ankuesja thekson se për shkak të procedurave të brendshme administrative ende nuk është përgatit diploma e studimeve master dhe se nuk ka mundur ta sjell të njëjtën, mirëpo e njëjta konsideron se ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme që vërtetohet se ka përfunduar studimet master me date 04.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe gjitha se bashku dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesja _____ ka përfunduar studimet themelore me datë 11.03.2016 dhe ka marrë titullin Bachelor për Ekonomik me gjithsej 180 kredi/ECTS, dhe kjo është vërtetuar përmes Diplomës me numër 6367 të datës 05.04.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës

"Hasan Prishtina". Ndërsa lidhur me përfundimin e studimeve master ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ka dorëzuar si dëshmi vetëm Formularin për mbrojtjen e punimit të diplomës master, të datës 04.03.2022, ndërsa me vonë gjate procesit të shqyrtimit të ankesës ankuesja ka dorëzuar si dëshmi edhe Raportin për verifikimin e të dhënave të aplikuarit Nr.2718 të datës 08.04.2022 dhe Vërtetimin me numër ref.nr.12/1595 të datës 12.04.2022 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kolegji vlerëson se Formulari për mbrojtjen e punimit të diplomës master, i datës 04.03.2022, i dorëzuara nga ankuesja me rastin e aplikimit, mund të shërbej si dëshmi për nevoja të brendshme të Fakultetit, gjegjësisht Universitetit, por jo edhe për nevoja të punësimit, sepse me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht nenin 135 përcaktohet se: *Përfundimi i suksesshëm i studimeve në përputhje me programin e studimeve vërtetohet nga Universiteti përmes diplomës që është dokument zyrtar.*

Ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesë i është referuar edhe dy dokumenteve tjera si Raportit për verifikimin e të dhënave të aplikuesit Nr.2718 të datës 08.04.2022 dhe Vërtetimit me numër ref.nr.12/1595 të datës 12.04.2022 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe pretendon se këto dokumente kanë qenë dëshmi e mjaftueshme përmes të cilave vërtetohet përfundimi i studimeve master, mirëpo Kolegji ka gjetur se të dy këto dokumente të cilave ju referohet ankuesja mbajnë datën e lëshimit 08.04.2022 gjegjësisht 12.04.2022, pas datës së fundit të mbylljes së konkursit që ishte data 06.04.2022, ndërsa me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 10 paragrafi 2 përcaktohet se: *2. Të gjitha shpalljet e konkurrimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: 2.2 Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen".*

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 29.03.2022 deri me datë 06.04.2022 nuk ka sjellë dëshmi të duhura për vërtetimin e përfundimit të studimeve master, nga autoriteti kompetent, në këtë rast Universiteti i Prishtinës, dhe në këtë mënyrë nuk ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me arsimimin, ku përcaktohej: *Arsimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare në Fakultetin Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diploma Master të jetë e njëjte apo vazhdim i diplomës Bachelor.* Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.04/2022 të datës 13.04.2022 për refuzimin e aplikacionit të ankueses dhe Vendimin me numër 11/2022 të datës 21.04.2022 për refuzimin e ankesës si të pa bazuar ka vërtetuar drejte dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë, dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.427/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Zyle Millaku Gojnovci
Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

